

# Kërkimi operacional në sistemin dhe shërbimet shëndetësore

*Në vitet 2020-2021, Projekti "Shëndet për të Gjithë" (HAP) bashkëpunoi me institucione akademike dhe organizata partnere për të forcuar kapacitetet në kërkimin operacional në shëndetësi.*

Në Shqipëri, mungesa e evidencës në Kujdesin Shëndetësor Parësor dhe në shëndetin publik krijon hendek mes hartimit të politikave, planifikimit dhe veprimeve konkrete për përmirësimin e rezultateve shëndetësore.

Në këtë kuadër, HAP ndër morri nismën "Mbështetje për kërkimin operacional në sistemin dhe shërbimet shëndetësore" në vitet 2020-2021 me dy objektiva kryesore:

- të mbështeste zhvillimin e kapaciteteve kërkimore të studiuesve të rinj përmes trajnimit dhe mundësisë për të zbatuar kërkim operacional;
- të krijonte mundësi financimi për kërkim operacional mbi aspekte të ndryshme të shërbimeve shëndetësore në Shqipëri, me fokus kujdesin shëndetësor parësor dhe shëndetin publik.



## Kontributi i HAP

Zhvilloi dhe zbatoi një program trajnimi për kërkimin operacional në shëndetësi me 12 module dhe 58 orë mësimore të hartuar nga 12 pedagogë.

Ofri mikrogrante për shtatë studiues të përzgjedhur në vitin 2020. Gjetjet kryesore, përmbledhjet teknike dhe rekomandimet për politikëbërësit u shpërndanë më pas përmes seminareve shkencore dhe faqes së HAP.

Kontribuoi në forcimin e etikës në kërkim, duke ofruar mbështetje teknike për rishikimin e kuartrit rregullator të Komitetit të Etikës në Universitetin e Mjekësisë, i cili u miratua nga Senati Akademik i UMT-së më 19 nëntor 2021.

### Rezultatet kryesore:

- 67 studentë, studiues të rinj dhe anëtarë të stafit akademik përfunduan me sukses programin e akredituar të trajnimit.
- 7 studiues të rinj përfunduan kërkimin e tyre dhe dorëzuan raporte shkencore dhe përmbledhje teknike.
- Universiteti i Mjekësisë ka tashmë një Komitet funksional të Etikës Kërkimore.

Pjesëmarrës në trajnimet mbi kërkimin operacional	Numri total
Përfitues të mikrogranteve dhe studiues të rinj në kërkim operacional	16
Specializantë në fushën e Shëndetit Publik dhe të Psikiatrisë në Fakultetin e Mjekësisë, UM, Tiranë	16
Stafi akademik i Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, UM, Tiranë	18
Stafi akademik i Fakultetit të Infermierisë, Universiteti i Shkodrës.	17

### Të dhëna kyçe:

Programi i trajnimit: 12 module të akredituara, 58 orë mësimore  
Pjesëmarrës në trajnim: 67 (11 meshkuj + 56 femra)  
Mikrogrante: 7